

Tualetet publike në qytetin e Prizrenit





Tualetet publike në qytetin e Prizrenit

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe


Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren &

Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 No.7, Prishtinë

www.ecmandryshe.org info@ecmandryshe.org

029 222 771 & 038 224 967

Ky hulumtim është realizuar nga EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit “Zbatimi i programeve të strategjisë të EC” i përkrahur nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) ‘EJA Kosovë’, bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida).



Gusht, 2022

HYRJE

Tualetet publike janë pjesë e jetës urbane dhe zënë vend të rëndësishëm në infrastrukturën e një hapësire publike, po aq sa zënë vend edhe parqet, ulëset, shportat e mbeturinave, ndriçimi publik, etj. Askush nuk mund të qëndroj gjatë në një vend pa pasur tualete publike.

Tualetet e përshtatshme publike janë thelbësore për dinjitetin njerëzor dhe janë veçanërisht sfiduese për grupet e marginalizuara siç janë; të moshuarit, PAK, gratë shtatzëna, fëmijët e vegjël, etj.

Nëse institucionet dëshirojnë që njerëzit t'i lënë makinat e tyre në shtëpi dhe të udhëtojnë me transport publik, me biçikletë ose në këmbë, atëherë sigurimi i tualeteve publike është thelbësor. Pasagjerët e transportit publik, këmbësorët dhe çiklistët ndryshe nga drejtuesit e makinave nuk mund të shpejtojnë në stacionin e shërbimit më të afërt. Andaj, e gjithë kjo do i sjellte të mira edhe mjedisit pasi që në këtë formë favorizohen dhe lehtësohet përdorimi i transportit urban, biçikletave dhe ecja në këmbë.¹

Në një hulumtim/vizionim të realizuar nga EC në vitin 2018 në Qendrën Historike të Prizrenit me qytetarë, thuhet se tualete publike të përshtatshme apo "të mirë dizajnuara" konsiderohen ato tualete që janë: funksionalisht të përshtatshme, të pastërta dhe pa lagështi, mirë të ventiluara, lehtë për tu mirëmbajtur dhe të qasshme për të gjithë.²

Të kesh qasje në tualete publike të pastra dhe të sigurta nuk është vetëm një pjesë jetike e shëndetit personal dhe publik, por është gjithashtu thelbësore për nxitjen e jetesës në qytete.³

Në të njëjtën kohë duhet menduar edhe për rregulloren dhe standartet e detyrueshme që i ofrojnë tualetet publike, pasi që mungesa e tyre rezulton në dizajn të dobët të tualetit, në mirëmbajtje dhe menaxhim joadekuat dhe kushte johigjienike, gjëra këto që do dërgonin në shfaqje dhe transmetim të sëmundjeve të ndryshme. Për të përmirësuar këtë duhet nxitur legjislacioni i detyrueshëm, rritja e fondeve dhe përmirësimi i regjimeve të menaxhimit, mirëmbajtjes dhe pastrimit.⁴

¹<https://www.researchgate.net/publication/245382911> The role of the public toilet Pathogen transmitter or health facilitator

² https://ecmandryshe.org/repository/docs/180312114622_1_compressed.pdf

³ <https://www.oier.pro/news/clean-safe-and-accessible-public-restrooms-make-cities-livable-87/#:~:text=Because%20having%20ready%20access%20to,people%20who%20are%20restroom%20challenged>

⁴<https://www.researchgate.net/publication/245382911> The role of the public toilet Pathogen transmitter or health facilitator

Tualetet e disponueshme lehtësisht gjithashtu nënkuptojnë zhvillim të biznesit dhe ndihmojnë në nxitjen e turizmit. Duke ditur se ka tualete publike të pastra dhe të sigurta, të arritshme lehtësisht, njerëzit janë më të prirur të vizitojnë parqet, të ngasin biçikletat, të vrapojnë dhe të ecin. Si rezultat i së cilës, gjithnjë e më shumë qytetet po investojnë në to.

Prizreni është një ndër qytetet më të mëdha për nga numri i popullsisë në vend. Në të njëjtën kohë Prizreni përfaqëson një qytet kulturor, gjë që e bënë që përveq frekuentimit të madh nga qytetarët vendas, ai të ketë vit për vit një frekuencë të madhe të vizitorëve (turistëve).

Po ashtu, Prizreni në përgjithësi ofron një numër të konsiderueshëm të hapësirave publike si: sheshe publike, parqe, monumente fetare, aktivitete të ndryshme, etj, por akoma nuk ka hapësira të dedikuara për tualete publike.

E njëjta gjendje përshkruhet edhe në vizionimin e lartë përmendur të realizuar nga EC, ku po ashtu tregohet se në Prizren nuk ofrohet shërbimi i tualeteve publike, dhe si rrjedhojë qytetarët kalimtarë të qendrës historike, e sidomos turistët, duhet të gjejnë alternativa të tjera për kryerjen e nevojave fiziologjike.

Kështu, për shkak të mungesës së një shërbimi bazik siç është komponentja e tualeteve publike, qytetarët ndikohen në shfrytëzim të limituar të hapësirave të tilla. Rëndom qytetarët të cilët kanë zgjedhur hapësirat publike për të kaluar momente të ditës së tyre, duhet të shpejtojnë për në kafenetë në afërsi në momentin që u nevojitet shfrytëzimi i tualetit. E njëjta aplikohet edhe te turistët që frekuentojnë monumentet historike apo pjesëmarrësit e festivaleve të ndryshme që ndodhin përgjatë kalendarit kulturor në Qendrën Historike të Prizrenit.


Mungesa e tualeteve publike ka ndikuar direkt edhe në cilësinë e higjienës në hapësirat publike. Në mungesë të tyre, rastet kur qytetarët shrytëzojnë hapësirat publike për të kryer nevojat fiziologjike nuk janë të pakta.⁵

Pra, mungesa e tualeteve publike ka qenë një shqetësim i vazhdueshëm për qytetarët e Prizrenit. Andaj për të kuptuar se sa janë të nevojshme sot për qytetarët e Prizrenit tualetet publike, EC Ma Ndryshe ka realizuar këtë hulumtim "Tualetet publike në qytetin e Prizrenit" me anë të anketave në terren.


⁵ https://ecmandryshe.org/repository/docs/180312114622_1_compressed.pdf

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është që të vlerësohen njohuritë e qytetarëve dhe kërkesat e tyre sa i përketë tualeteve publike në qytetin e Prizrenit duke përfshirë këtu shtimin në numër të tyre, mirëmbajtjen, sigurinë, qasjen etj.


EC ka kërkuar informata dhe dokumente publike nga komuna e Prizrenit për ekzistencën e tualeteve publike dhe planet për ndërtimin e tyre dhe njëkohësisht ka vazhduar më tutje me realizimin e anketave në terren me qytetarët, ku gjithsej janë anketuar 140 qytetarë, nga të cilët 67 ishin gra dhe 73 burra. Lagjet në të cilat është zhvilluar anketa janë këto: Arbanë, Bajram Curr, Bazhdarhane, Dardani, Hoça Mahallë, Jeni Mahallë, Jeta e Re, Kurillë, Lakuriq, Ortakoll, Petrovë, Qendra Historike, Ralin, Tabakhane, Terzimahallë dhe Tusuz.




● A keni njohuri se a ka tualete publike në qytetin tuaj?




● A mendoni se është e nevojshme të ketë tualete publike në qytetin tuaj?




● A do i përdorni tualetet publike nëse do të ekzistonin?



● Nëse JO pse?





● Në qoftë se do të planifikoheshin tualetet publike në qytetin tuaj, ku mendoni se janë më të nevojshme?




● Në qoftë se do të planifikoheshin tualetet publike në qytetin tuaj, cilat nga cilësitë e mëposhtme do t'i preferonit?




● Në qoftë se do të planifikoheshin tualetet publike në qytetin tuaj, a mendoni se ato do të duhej të monitoroheshin?






- Në qoftë se po, si do të preferonit të monitoroheshin tualetet publike në qytetin tuaj?



- Sipas mendimit tuaj, a duhet përdorimi i tualeteve publike të jetë me pagesë?



- Nëse përdorimi i tualeteve publike do të ishte me pagesë, sa mendoni se do duhej të kushtonte?



PËRFUNDIME

2.1 Përfundimet nga kërkesa drejtuar komunës së Prizrenit:

Në pyetjet e përpiluara nga EC sa i përket gjendjes me tualetet publike në komunën e Prizrenit, zyrtarët kanë treguar se në planet e komunës janë edhe ndërtimi i tualeteve publike, pasiqë komuna e Prizrenit konsiderohet si kryeqytet kulturor me një trashëgimi dhe me shumë monumente historike, si rrjedhojë e së cilës ka një turizëm shumë të zhvilluar dhe shumë aktivitete tjera kulturore që zhvillohen në qendër të qytetit, kjo duke rritur domosdoshmërisht krijimin e shërbimeve publike për nevoja të domosdoshme ditore të njeriut.

Andaj sipas tyre kjo mungesë e ofrimit të shërbimeve të tilla komunale gjegjësisht ndërtimi i së paku një tualeti publik, është identifikuar nga ta si një propozim i domosdoshëm në përmirësimin e cilësisë për qytetarët, përkatësisht për vizitorët në qytetin tonë.

Ata më tutje shtuan se ky propozim do të jetë pjesë e projektit që Drejtoria e Shërbimeve Publike është duke e punuar për një sistem të qëndrueshëm të këtyre shërbimeve publike.

2.2 Përfundimet e pyetësorit me qytetarët e Prizrenit:

- ❖ Qytetarët fillimisht janë pyetur mbi njohuritë e tyre se a ekzistojnë tualete publike në qytetin e Prizrenit, ku nga 140 të anketuar 95.7% janë përgjigjur se "Jo" nuk ka tualete publike dhe vetëm 4.3% e tyre kanë thënë që "Po" ka. Pyetësi më tutje ka vazhduar me qytetarët që janë përgjigjur me "Jo" në pyetjen fillestare pasiqë në qytetin e Prizrenit, ashtu siq janë përgjigjur edhe zyrtarët komunal nuk ekzistojnë tualetet publike.
- ❖ Më tutje qytetarët janë pyetur se a është e nevojshme të ketë tualete publike në qytetin tuaj, ku nga 134 të anketuarit, 91% kanë thënë që "Po" është e nevojshme, 6% kanë thënë "Jo" dhe vetëm 3% janë përgjigjur me "nuk e di".
- ❖ 82.8% e qytetarëve të anketuar janë përgjigjur me "Po" kur janë pyetur se a do ti përdornin tualetet publike nëse do të ekzistonin, dhe vetëm 17.2% e tyre kanë thënë se "Jo" nuk do t'i përdornin.
- ❖ Më tutje, të anketuarit që janë përgjigjur me "Jo" janë pyetur se cilat janë arsyet se pse nuk do i përdornin tualetet publike, arsyet më të shpeshta kanë qenë ato se zakonisht në hapësira publike mungon mirëmbajtja dhe higjiena.

- ❖ Kur qytetarët janë pyetur se në qoftë se do të planifikoheshin tualetet publike në qytetin tuaj, ku mendoni se janë më të nevojshme, 37.9% e tyre kanë thënë se tualete duhet të ketë në afërsi të sheshit kryesor, 34% mendojnë se tualetet duhet të ekzistojnë në afërsi të parqeve publike, 23.8% të tjerë kanë thënë se tualetet janë të nevojshme në afërsi të tregjeve, ndërsa 4.3% e qytetarëve si opsione kanë dhënë vendet si; afër shkollave, tek Kalaja e Qytetit, në segmente më të gjata rrugore brenda Prizrenit dhe në secilën lagje dhe në çdo hapësirë publike brenda qytetit.
- ❖ Në vazhdim qytetarët janë pyetur edhe për cilësitë që duhen të posedojnë tualetet publike nëse do të ndërtoheshin, në këtë rast 33.1% e qytetarëve kanë thënë se tualetet publike duhet të jenë të sigurta për të gjithë (me theks për gratë dhe vajzat), 30.2 % kanë thënë se duhet të jenë të qasshme për të gjithë (me theks për personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe prindërit në përcjellje të fëmijëve me karrocë), 20.9% të tjerë kanë kërkuar të kenë hapësirë për ndërrimin e foshnjave, ndërsa 15.9% janë përgjigjur me atë se duhet të ketë hapësirë për gjdhënie.
- ❖ Siguria dhe mirëmbajtja sa i përket planifikimit të tualeteve publike është një ndër pikat ku duhet shtuar shumë kujdes, andaj qytetarët janë pyetur se a do të duhej të monitoroheshin tualetet publike: 92.5% prej tyre kanë thënë se “Po” do duhej të monitoroheshin dhe vetëm 7.5% kanë thënë se “Jo” nuk duhet të monitoroheshin.
- ❖ Të anketuarit që janë përgjigjur me “Po”, më tutje janë pyetur se si do të preferonin të monitoroheshin tualetet publike në qytetin tuaj, në të cilin rast 56% e qytetarëve kanë thënë se tualetet duhet të monitoroheshin nga mirëmbajtësi apo kujdestari dhe 44% të tjerë kanë zgjedhur kamerat e sigurisë si formë monitorimi.
- ❖ Në fund, qytetarët janë pyetur se a duhet përdorimi i tualeteve publike të jetë me pagesë, ku 56% e tyre kanë thënë që “Po” duhet të jenë dhe 43.3% të tjerë kanë thënë se “Jo” nuk duhet të jenë.
- ❖ Qytetarët të cilët në pyetjen sipër janë përgjigjur me “Po”, i kemi pyetur më tutje se sa mendojnë se do të duhej të kushtonte përdorimi i tualeteve publike, e në këtë rast çmimi nga 5 deri në 10 cen është sugjeruar nga 5.7% e qytetarëve, çmimi 20 deri në 40 cent është sugjeruar nga 29.3% e qytetarëve dhe çmimi nga 50 cent deri në 1 EURO u sugjerua nga 17.8% e tyre. Po ashtu, 0.14% e qytetarëve të anketuar sugjeruan që pagesa do të duhej të përcaktohet në varësi të shërbimeve dhe se do duhej të përfshihej në faturën e mbeturinave si harxhim mujor.

REKOMANDIME

- Komuna nevojitet që me urgjencë të trajtojë mungesën e toaleteve publike, pasi që nga ky hulumtim del se qytetarët janë mjaftueshëm të informuar sa i përket ekzistencës së tualeteve publike në qytetin e Prizrenit dhe në të njejtën kohë del si kërkesë edhe nevoja për ndërtimin i tyre në hapësira publike. Andaj, planifikimi sa më i shpejtë i tyre është shumë i rëndësishëm dhe duhet të jetë prioritet i komunës.
- Gjithashtu, rekomandohet që gjatë përcaktimit të lokacioneve se ku do të ndërtohen tualetet publike të diskutohet dhe të mbahen punëtori me qytetarë në mënyrë që të përfshihen të gjitha kërkesat e tyre.
- Kësaj i shtohet edhe përfshirja e grupeve të marginalizuara (të moshuar, PAK, e prindër me fëmijë të vegjël) ku rekomandohet që të merren parasysh edhe kërkesat e tyre, duke u dizajnuar kështu module praktike, jo të kushtueshme e shumë funksionale, të përshtatshme për të gjithë.
- Rekomandohet që të hartohet një plan strategjik sa i përket mirëmbajtjes dhe sigurisë në tualetet publike. Në këtë rast duhet të përfshihen mirëmbajtja, resurset njerëzore dhe materiale, shpenzimet, etj. Kjo duhet të del pas një analize më të gjerë, pasi që parë nga ky hulumtim qytetarët janë të ndarë në dy mendime të kundërta sa i përket çështjes së pagesës. Andaj duhet punuar në atë formë që këto investimet të jenë afatëgjate.

PËR EC

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikëqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme:

1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale,
2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe
3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 - 2024) ka këto elemente: 1. Gjithëpërfshirjen, 2. Qëndrueshmërinë, dhe 3. Dijen.

EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga poshtë lart.

Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

1. Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;
2. Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;
3. Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura;
4. Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.